

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rezultatet e dobëta tronditin CDU-në, Merz ultimatum drejtuesve të partisë: Më mbështesni ose jap dorë heqjen
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/rezultatet-e-dobeta-tronditin-cdu-ne-merz-ultimatum-drej-tuesve-te-partise-m-i586342
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:50:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6d84c85f85a139ab92b778bbd2e30acaf056b3e88bb90ea1dd8d0babd28f5556
TEKSTI	afbc3c8dfe61e0dae4a8b9516c8bbeb6d7853951fa64be61c8fe1efbdfae2df5
PAMJA	efe8a4bbd0083855771647851c77802238da0978a76b746eee138541e0237d6f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	957feb6f42ef9d1a01fbfad83759e2950ba3af5ea948a698af96529f9d4d5901
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/957feb6f42ef9d1a01fbfad83759e2950ba3af5ea948a698af96529f9d4d5901>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



ie [Rezultatet e dobëta tronditin CDU-në. Merz ultimatum drejtuesve të partisë: Me mbështesni ose jap dorëheqjen](#) Rusia mban zgjedhjet e para që nga nisja e pushtimit të Uj fundit

Rezultatet e dobëta tronditin CDU-në, Merz ultimatum drejtuesve të partisë: Më mbështesni ose jap dorëheqjen



15 Shtator 2026, 21:50Bota TEMA



Nën presionin e rezultateve të njëpasnjëshme negative në zgjedhje dhe vlerësimeve të ulëta të Partisë Kristian Demokratike (CDU) dhe të vetë kancelarit në sondazhet e opinionit, Friedrich Merz pritet të kërkojë në mënyrë indirekte një votëbesim nga udhëheqja e partisë së tij.

Sipas revistës "Stern" dhe faqes së internetit "Table.Media", të dielën në mbrëmje, pas zgjedhjeve shtetërore në Mecklenburg-Pomeraninë Perëndimore dhe Berlin, Merz planifikon t'i paraqesë komitetit ekzekutiv të CDU-së një ultimatum: ose të gjithë do të bien dakord për një kurs të unifikuar reformash nën udhëheqjen e tij, ose ai do të paraqesë dorëheqjen. Megjithatë, ai nuk ka ndërmend të japë dorëheqjen vullnetarisht nga detyra.

Siç thekson "Stern", anëtarët e komitetit kanë marrë tashmë një ftesë për një takim në orën 17:00, sipas orës lokale, të dielën.

Përveç kësaj, sipas faqes së internetit "Table.Briefing", ka zëra se Friedrich Merz do të paraqesë disa pika me të cilat partia synon të nisë diskutimet me partnerin e saj qeveritar, SPD-në. Këto pika përfshijnë lehtësime më të larta tatimore dhe masa për uljen e çmimeve të energjisë.

Me këtë veprim, kancelari synon të sigurojë mbështetjen e kryeministrave të landeve Hendrik Wüst, Daniel Günther dhe Boris Rhein.

Merz madje ka shtyrë nisjen e tij për në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në mënyrë që të marrë pjesë në takimin e grupit parlamentar të CDU-së të martën.

Ditët e fundit, ka pasur spekulime për zëvendësimin e Friedrich Merz në kancelari, një skenar që, sipas mediave gjermane, mbështetet nga rreth 30 deputetë të CDU-së.

Ndërkohë, ministri federal i Brendshëm, Alexander Dobrindt (CSU), ka mohuar thashethemet se ai mund të jetë një zëvendësim i mundshëm për kancelarin.

Më herët, kreu i partisë së tij, Markus Söder, kishte siguruar se CSU nuk do të shkaktonte rrëzimin e qeverisë.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Rusia mban zgjedhjet e para që nga nisja e pushtimit të Ukrainës](#)

21:40 Bota

[Ekspertët ligjorë britanikë i kërkojnë Londrës embargo të plotë armësh ndaj Izraelit](#)

21:30 Bota

U arrestua nën dyshimin për sulm, dorëhiqet udhëheqësi i Reform UK në Uells

21:20 Bota

Italia zgjat kontrollin ajrore dhe detare me Spanjen

21:10 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.